



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 449/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Nenad Lazić dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dega në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik të Pavarurit e Mitrovicës dega në Mitrovicë, për shkak të pengimit të procesit zgjedhor , për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.11.2013, mori këtë:

### VENDIM

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), dega në Prishtinë .

### Arsyetim

Me datën 03.11.2013, subjekti politik PDK, ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendon se, në Mitrovicë, në fshatin Bair, në shkollën “Ismail Qemajli” e njëjta Qendër e Votimit (QV) me nr.1104B/09 vëzhguesit nga subjekti politik “Të Pavarurit e Mitrovicës” kanë theksuar se, Ilir Xhemali vazhdimisht qëndronte duke i penguar komisionarët dhe në veçanti komisionarin e PDK-së. Parashtruesi i ankesës ka theksuar se veprimi i tillë është në kundërshtim me dispozitat e nenit 33 pika g e LZP-së .

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

### ankesa është e pabazuar

PZAP-i, gjeti se pretendimet e tilla ankimore nuk qëndrojnë, ngase pohimet e lartçekura nga parashtruesi i ankesës nuk janë objektive, me të cilat vihet në dyshim se është kryer një veprim i ndaluar, për arsye se nuk është ofruar asnjë dëshmi me të cilën do të vërtetohej një pretendim i tillë ankimorë, shikuar sipas dispozitës së nenit 3.6 pika c) e Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it duke marr parasysh arsyet e sipërsënuara PZAP-i, konstatoi se një pretendim i tillë është i përgjithshëm dhe i pa qartë për tu administruar si provë relevante prandaj ankesa vlerësohet si e pa bazë duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 449/2013 më datën 06.11.2013.

Kryesuesi i Panelit  
Muhamet Rexha



### **Këshillë Juridike:**

PZAP-i nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*